



**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Prizren**



**KOLEGJI - COLLEGE  
BIZNESI**  
Prishtinë

**Kolegji BIZNESI**

### **MEMORANDUM BASHKPUNIMI**

Ky memorandum lidhet ndërmejt palëve të mëposhtme:

**Kolegji BIZNESI**, që është institucion privat i arsimit të lartë në Kosovë, i Akredituar nga "Agjencia Kosovare e Akreditimit", dhe i licensuar nga "Ministria e Shkencës dhe e Teknologjisë", që ka si objective të sigurojë veprimtari arsimore dhe shkencore, kultivimin e dijes dhe shkencës, mbështetjen e shoqërisë në aspektin ekonomik dhe social, si dhe afirmimin e vlerave kombëtare dhe evropiane.

**Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Prizren**, institucion në komunën e Prizrenit.

Palët bien dakord të respektojnë qëllimin e këtij Memorandum Bashkpunimi si më poshtë:

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

1. **Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport** do të ndihmojë dhe mbështesë në vazhdimësi **Kolegjin Biznesi**, në pranimin e studentëve për realizimin e praktikës, dhe dhënjën e sygjërimeve për nevojat e ekonomisë së tregut si pal e interesit nga jashtë, të bazuar në politikat e këtij institucionit. Për të gjitha komunitetet: Shqiptarë, Boshnjak, Turk, Romë.
2. **Kolegji Biznesi** do të mbështesë në vazhdimësi **Drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport** në aspektin e trajnimeve në fushat: **Menaxhimi i Emergjencave** (mbrojtjes nga zjarrit duke kontrolluar dhe servisuar aparaturat për shuarjen e zjarrit), **Ekonomis** (hartimin e pasqyrave financiare dhe planit të biznesit), **Juridike** (hartimi i kontratave dhe rregulloreve) dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale të personelit .



3. **Kolegji Biznesi** do të mbështes **Drejtorin për Kulturë, Rini dhe Sport** me stafin e sajë akademik, për ligjërata nga lëmia: emergjencave, ekonomis dhe juridikut-sipas nevojave që paraqet Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

#### **Neni 2**

##### **Objekti**

- Të dyja institucionet dekalrojnë se janë të gatshme të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e këtij Memorandumi me qëllim të aftësimit të studentëve.

#### **Nenti 3**

##### **Komunikimi**

- Palet do të caktojnë persona kontakti që do jenë përgjegjës për zbatimin e Memorandumit, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i të dhënave të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm. Në raste e shmangies nga procedurat e percaktuara në këtë Memorandum, palët do të merren vesh për procedura të pranueshme komunikimi në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### **Neni 4**

##### **Ndryshime**

- Memorandum mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndersjelltë me shkrim të palëve

#### **Neni 5**

##### **Afati i Memorandumit të Bashkpunimit**

- Memorandumi lidhet me një afat pesë (5) vjeçar duke filluar 02.12.2020 deri me 02.12.2025
- Memorandumi mund të vazhdohet me vullnetin e palëve për një afat tjetër të percaktuar.
- Përfundimi do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimit me shkrim nga pala tjetër.
- Deri në përfundimin e këtij Memorandumi, palët do t'u përmbahen termave dhe kushteve që rrjedhin nga ky Memorandum, përsa sa i përket informacionit dhe dokumentave të shkëmbyera përpara dates së përfundimit të tij.




**Neni 6**  
**Hyrja në Fuqi**

- Ky Memorandum Bashkupunimi hyn në fuqi menjherë pas nënshkrimit të tij nga përfaqësuesit e palëve. Memorandumi përgatitet dhe nënshkruhet në 4 ( katër ) kopje origjinale, dy prej të cilave në Komunen e Prizrenit dhe dy të tjera në Kolegjin "BIZNESI"
  
- Ky Memorandum Bashkupunimi u nënshkrua sot me datë 04.12.2020.

PËR KOLEGJI BIZNESI

**Prof. Dr. Shyqeri KABASHI**

/Dekani/



PËR KOMUNEN E PRIZRENIT

**Emilija Redzeqi**

/Drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport/



**Prizren 04.12.2020**